

Shenime

1. Informacion i pergjithshem per Shoqerine

Shoqeria "TRIMED" SHPK, Tirane eshte themeluar si nje shoperi me perjegjesi te kufizuar me 01 Dhjetor 2004, qe ushtron veprin tarine ekonomike kryesisht ne import eksport te barnave mjeksore , ne tregimin me shumice te medikamenteve dhe materialeve mjeksore, tregimin e artikujve kozmetike dhe produkteve te tjera , tregimin e pajisjeve mjeksore dhe instrumentave ortopedike, protezave te artikuluacioneve dhe impainteve dentare e dhenie/marrje me qira te pronave te paluajtshme, dhenie/marrje ne perdonim si edhe qdo aktivitet tjeter ekonomik te parashikuar nga ligji ne fushen e pronave te paluajtshme, etj.

Shoqeria eshte regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me date 09 Dhjetor 2004 dhe eshte pajisur me NIPT K51612031J .

Kapitali i shoqerise eshte ne vleren prej 60,900,000 leke dhe pjesmarrja ne kapitalin e shoqerise eshte si vijon : Ortaku z. **Shani Peposhi zoteron 40 % te kapitalit** , ortaku **z. Gentiana Peshkatari zoteron 10 % te kapitalit** ndersa ortaku **z. Dominic Noel William Evans zoteron 50 % te kapitalit te shoqerise** . Administratore e shoqerise eshte znj Gentiana Peshkatari

Organizmi i saj rregullohet sipas ligjit 9901 date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" . Selia e shoqerise TRIMED SHPK eshte ne adresen : Tirane – Durres , Km 10 , godina trekateshe , Kashar ,Tirane .

Gjate vitit 2018 shoqeria ka pasur mesatarisht te punesuar ~~L~~ punonjes.

2. Bazat e pergatitjes se pasyrave financiare

(a) Deklarata e parimeve kontabel

Shoqeria pergaat pasqyrat financiare ne perputhje me legjislacionin kontabel ne Shqiperi. Pasqyrat financiare jane pergaatitur ne perputhje me Ligjin nr. 9228, date 29 Prill 2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Standardet Kombetare te Kontabilitetit te Permiresuara. Drejtimi i Shoqërisë vlereson se do te vijoje aktivitetin normal tregtar per dymbëdhjetë muajt e ardhshëm që pasojnë muajin e mbylljes se këtyre pasqyrave financiare. Si rrjedhojë këto pasqyra janë përgatitur mbi bazën e parimit te vijueshmërisë.

(b) Parimet e perqatitjes

Pasqyrat financiare janë perqatitur mbi bazen e parimit te kostos historike. Politikat kontabel te meposhtme janë zbatuar per pasqyrat financiare.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Keto pasqyra financiare janë perqatitur ne Leke (monedha Shqiptare) ne perputhje me legjislacionin kontabel ne Shqiperi.

3. Politikat kontabile kryesore

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e kembimit zyrtar per monedhat kryesore te perdorura ne perkthimin e zerave te bilancit kontabel te cilat shprehen ne monedhe te huaj me 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 jane si vijon :

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
1 EUR	123.42	132.95
1 USD	107.82	111.10

3.2 Instrumentat finanziarë

Instrumentat finanziarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat finanziarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksi që lidhet me to, përvëç siç përshkruhet më poshtë.

Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpermjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument finansiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit finansiar ose kur shoqëria transferon aktivin finansiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve finansiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

a) Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat bankare me maturitet tre muaj ose me pak nga data e lidhjes se kontrates. Ekuivalentet e parase perfshijne investime afatshkurtra, shume likuide, te cilat jane lehtesish te konvertueshme ne para dhe kane një trezik minimal persa i perkthet ndryshimit te vleres se drejtë.

b) Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni per zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat per tu arketuar sipas kushteve te kontrates. Veshtirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentoje ose riorganizimi i tij finansiar, mospagesa ose vonesa në pagesa konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizonit llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Kostoja e amortizuar e llogarive dhe kerkesave te arkëtueshme afatshkurtra ne per gjithësi eshte e barabarte me vleren e tyre nominale (minus zhvlersimet e krijuara per renien ne vlerë).

c) Detyrimet financiare (Llogari të pagueshme)

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Detyrimet financiare mbahen ne vazhdim me koston e amortizuar. Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferenca midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarjes duke u bazuar në interesin efektiv

d) Metoda e interesit efektiv

Metoda e interesit eshte një metode per perllogaritjen e kostos se amortizuar te një detyrimi financiar dhe e shperndarjes se shpenzimeve te interesit per gjate periudhes. Norma e interesit eshte norma qe skonton rrjedhat e ardhshme te pagesave gjate kohezgjatjes se parashikuar te detyrimit financiar ose kur eshte pershtatshme, një periudhe me te shkurter..

e) Të tjera

Instrumenta të tjera jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

f) Zhvlersimi i aktiveve financiare

Në fund të çdo periudhe raportimi, një njësi duhet të vlerësojë nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njësia duhet të njohë menjëherë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje

Evidencia objektive që një aktiv financiar ose një grup aktivesh financiare janë zhvlerësuar përfshin ngjarjet e mëposhtme të cilat vijnë në vëmendjen e mbajtësit të aktivit: (a) vështirësi financiare domethënëse të emetuesit ose detyruesit. (b) një shkelje kontrate, si mospagesë ose pamundësi pagese të interesit ose principalit. (c) kreditori, për arsyen ekonomike ose ligjore që lidhen me vështirësinë financiare të debitorit, i ofron këtij të fundit koncesione që kreditori nuk do t'i ofronte në kushte të tjera. (d) është bërë e mundshme që debitori do të kalojë në falimentim ose riorganizime të tjera financiare. (e) të dhënat tregojnë që ka patur një rënie të matshme në flukset e ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare nga një grup aktivesh financiare që nga njohja e tyre, edhe pse rënia nuk mund të lidhet me një aktiv financiar të caktuar brenda grupit, të tilla si kushte ekonomike të dëmshme kombëtare ose vendore ose ndryshime të dëmshme në industri.

Nëse, në një periudhë pasuese, shuma e humbjes nga zhvlerësimi zgjodhjet dhe zgjelimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi ishte njohur zhvlerësimi (si një përmirësim në vlerësimin e pozicionit financiar të debitorit), njësia ekonomike duhet të rimarrë humbjen nga zhvlerësimi të njohur më parë ose direkt ose duke irregulluar një llogari zhvlerësimi

Rimarrja nuk duhet të rezultojë në një vlerë kontabël të aktivit finansiar (netuar me ndonjë llogari zhvlerësimi) që tejkalon atë vlera kontabël që do të kishte qenë nëse nuk do të njihej humbja nga zhvlerësimi. Njësia duhet të njohtë menjëherë shumën e rimarrjes në fitim ose humbje.

g) Cregjistrimi i aktivit finansiar

Një njësi duhet të çregjistrojë një aktiv finansiar vetëm kur: (a) të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare nga aktivit finansiar skadojnë ose shlyhen, ose (b) njësia i transferon një pale tjetër pothuajse të gjitha risqet dhe përfitimet nga zotërimi i aktivit finansiar, ose (c) njësia, pavarësisht se ka mbajtur disa risqe dhe përfitime domethënëse të zotërimit, ka transferuar kontrollin e aktivit tek një pale tjetër dhe pala tjetër ka aftësinë praktike për të shitur aktivin në tërësinë e tij një pale të tretë të palidhur dhe është në gjendje të ushtrojë këtë aftësi në mënyrë të njëjanshme dhe pa pasur nevojë të imponojë kufizime shtesë në lidhje me këtë transferim.. Çdo diferencë mes shumës së marrë dhe shumave të njoitura dhe të çregjistruara në përputhje me këtë paragraf duhet të njihet në fitim ose humbje në periudhën kur ka ndodhur transferimi.

• Inventaret

a) Matja fillestare

Inventarët maten fillimisht me kostos. Kostoja e inventarit përfshin: koston e të gjitha materialeve të lidhura drejtpërdrejt me prodhimin si dhe koston e shndërrimit të këtyre materialeve në produkte përfundimtare. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përvèç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese. Kostoja e lëndëve të para, materialeve të konsumit, tokës dhe ndërtesave të blera për rishitje, përbëhet nga çmimi i blerjes, shpenzimet e transportit, taksat e importit, magazinimi, zbritjet dhe shtesat tregtare dhe të tjera shpenzime të tjera të ngashme (taksat e parimbursueshme).

b) Vlerësimi i mepasshem

Pas njoftes, një njësi ekonomike duhet të matë inventarin me vlerën më të ulët midis kostos dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për tu përfunduar dhe shitur

c) Zhvlerësimi i inventarit

Inventaret duhet t'i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e raportimit. Kërkesa për vlerësimin e inventarit me vlerën më të ulët mes kostos dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për tu përfunduar dhe shitur e detyron njësine ekonomike që të regjistrojë në kontabilitet humbjet nga zhvlerësimi në momentin kur ky i fundit ndodh.

• Aktivet afatgjata materiale

a) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale janë parqitur me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtëpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtëpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjëndjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

b) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabel të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme që lidhen me mirmbajene dhe riparimet e vazhdueshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

c) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të cdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marrta me qira amortizohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të cdo pjese të aktivit afatgjatë material dhe duke marrë përbazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

Metodat dhe përqindjet e amortizimit për secilën kategori aktivesh afatgjata për periudhën aktuale janë llogaritur mbi vleren mbetur si vijon:

- Instalime teknike makineri dhe pajisje	20 %
- Automjete	20 %
- Pajisje zyre	20 %
- Pajisje informatike	25 %

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në cdo datë raportimi.

d) Zhvlersimi i aktiveve afatgjata materiale

Një humbje nga zhvlerësimi ndodh kur vlera kontabël neto e një aktivi tejkalon shumën e rikuperueshme. Një njësi ekonomike duhet të njoftë një humbje nga zhvlerësimi menjëherë në fitim/ humbjen e vitit. Një test zhvlersimi kryhet ne cdo date te raportimit (bilancit) per aktivet qe tregojne shenja te renies ne vlere. Testi i zhvlersimit kryhet me qellim qe te percaktohet shuma e rikuperueshme e nje aktivi afatgjate e cila eshte shuma me e larte midis vleres se drejte te nje aktivi afatgjate (minus koston e shitjes) dhe vleres ne perdorim te tij. Vlera kontabel neto aktivit reduktohet nese si vlere e tij e drejte (minus koston e shitjes) ashtu edhe vlera ne perdorim jane me te ulta se vlera e tij kontabile. Nese ka shenja qe shuma e rikuperueshme e nje aktivi afatgjate eshte rritur mbi vleren kontabel , humbja e meparshme nga zhvlersimi rimerret dhe vlera kontabel e aktivit rritet dhe kufiri me i larte i rritjes eshte vlera e meparshme kontabile e aktivit afatgjate minus amortizmin gjate viteve te ndermjeteme ,sikur te mos ishte njoftuar me pare renie ne vlere.

Rimarrja e nje renie ne vlere njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve per periudhen reportuese si nje pakesim i humbjes nga zhvlersimi .

e) Cregjistrimi

Nje aktiv afatgjate material cregjistrohet kur ai nxirret jashteperdorimit apo kur nuk priten me perfitime te ardhura ekonomike nga perdorimi apo nxjerra jashteperdorimit te tij. Cdo fitim ose humbje qe vjen nga cregjistrimi i aktivit (percaktuar si diferecë mes arketimeve te shitjes dhe vleres se mbetur te aktivit) njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur aktivit cregjistrohet.

• Provisionet

Provisionet njihen kur Shoqeria ka nje detyrim aktual (ligjor ose te terthorte) si rezultat i nje ngjarje ne te kaluaren dhe ka mundesi qe do te nevojitet nje fluks burimesh qe perfshin perfitimet ekonomike per te permッシュ detyrimin dhe ne kete menyre mund te behet nje perllogaritje e besueshme e shumes se detyrimit. Ne rast se efekti eshte material, provisionet jane percaktuar duke skontuar flukset e pritshme te parase me normen e uljes para tatimeve, e cila reflekton vleren kohore te parase ne kushtet aktuale te tregut dhe, aty ku eshte e pershtatshme, normen e riskut te pasiveve specifike.

Provisionet rishikohen ne çdo date bilanci dhe nese nuk ka me mundesi per nevojitet e nje fluksi burimesh qe perfshin perfitimet ekonomike per shlyerjen edetyrimit, provisionet kthehen.

Provizonet perdoren vetem per qellimin qe jane njojur fillimisht. Ato nuk njihen per humbjet e ardhshme operative. Aktivet e kushteuara nuk njihen

• **Te ardhurat dhe shpenzimet**

Te ardhurat nga shitja jane vleresuar me vleren e drejte te shumes se arketuar ose te arketueshme, duke marre parasysh shumen e zbritjeve te oftruara dhe taksave te lidhur me shitjet. Te ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur shoqeria i ka kaluar bleresit te gjitha rreziqet dhe perfitimet qe lidhen me pronesine e mallrave , kur eshte i mundur kthimi i shumes, kur shpenzimet e bera ne lidhje me transaksionin dhe kthimet e mundeshme mund te maten me besueshmeri , kur shoqeria vazhdon te jete e perfshire ne menyre te vazhdueshme ne menaxhmin e mallrave dhe shuma e te ardhurave mund te matet me besueshmeri. Transferimi zakonisht ndodh kur produkti i kalon klientit ne piken e shitjes.

Shoqeria njeh si shpenzim cdo shtes te rezervave per provizone kundrejt rreziqeve , humbjeve , demtimit fizik ose kthimeve te mundshme qe njihen ne daten e pasqyrave financiare .

8. Shpenzime te personelit

a) Kontributet per sigurime shoqerore dhe te ngjashme

Shoqeria, gjate aktivitetit te saj normal, kryen pagesa ne emer te saj dhe te punonjesve te saj per kontributet per sigurimet shoqerore dhe shendetesore ne pajtim me legjislacionin ne fuqi. Kostot perkatese te bera ne emer te shoqerise ngarkohen ne pasqyren e te ardhurave me ndodhjen e tyre.

b) Leje e zakonshme e paguar

Shoqeria njeh si nje shpenzim personeli ato kosto qe lidhen me lejen e zakonshme atehere kur eshte perdonur nga personeli perkates.

a. Shpenzimet e shfrytezimit

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin

9. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur akumulohen, duke marre parasysh metoden e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare perfshijne shpenzimet e inteteresit per huante marra , humbjet e kursit te kembimit , ndryshimet ne vleren e drejte te aktivit finannciar nepermjet fitimit ose humbjes (ne se ka) dhe humbjeve nga zhvlersimi i aktiveve financiare .

TRIMED SH.P.K TIRANE
NIPT: K51612031J

10. Tatim Fitimi

Tatim fitimi apo humbjet e vtitit perbehen nga tatimi aktual dhe ai i shtyre. Tatim fitimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve perveç rasteve kur lidhet me zera qe njihen direkt ne kapital, rast ne te cilin edhe tatimi njihet ne kapital. Tatimi aktual eshte tatimi i pritur per t'u paguar mbi fitimin e tatueshem te vtitit, duke aplikuar normat tatimore ne fuqi ne daten e bilancit, si edhe çfaredolloj rregullimi kontabel te tatimit per t'u paguar ne lidhje me vitet e meparshme. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin per periudhen ushtrimor 2018 eshte 15 % e fitimit te tatueshem

11. Menaxhimi i riskut financiar

Shoqeria ekspozohet ndaj riskut te kredise, riskut te likuiditeteve dhe riskut te tregut nga perdonimi i instrumentave financiare.

Politikat e manaxhimit te riskut jane vodosur per te identifikuar dhe analizuar rreziqet me te cilat perballat shoqeria, per te vodosur limitet dhe kontrollet e nevojshme per risqet dhe per te monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e manaxhimit te riskut rishikohen rregullisht per te reflektuar ndryshimet ne kushtet e tregut dhe aktivitetet e Shoqerise.

➤ AKTIVET

1. MJETET MONETARE

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
I	Banka dhe institucionet te tjera financiare			
1	Vlera monetare ne banke	512	17,166,685	31,619,498
1.1	- Vlera monetare, ne leke	5121	16,061,679	28,262,619
1.2	- Vlera monetare , ne monedha te huaja	5124	1,105,006	3,356,879
II	Vlera ne arke	53		
2	Vlera monetare ne arke	531	1,488,925	1,830,639
2.1	- Vlera monetare, ne leke	5311	1,488,925	1,830,639
III	Totali mjete monetare		18,655,610	33,450,137

2. TE DREJTA TE ARKETUESHME

2.1 Te drejta ndaj Klienteve vlera neto

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Kliente per mallra, produkte e shermive	411	301,608,818	199,861,735
2	Zhvleresimi i te drejtave dhe detyrimeve (teprica kreditore)	491	(26,833,267)	
	Totali i te drejtave te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit (1+2+3+4)		274,775,551	199,861,735

TRIMED SH.P.K TIRANE
NIPT: K51612031J

2.2 Kerkesa te arketueshme tatimore

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Shteti -TVSH per t'u marrë	4454	6,443,884	1,199,109
2	Te tjera tatime per t'u paguar dhë per t'u kthyer -tvsh per rimbursim	447	17,322,769	27,322,769
	Totali - Nga rjesite ekonomike brenda grupit (1+2)		23,766,653	28,521,878

2.3 Te Tjera kerkesa te arketueshme

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Debitore te ndryshem	467	2,862,509	29,599,702
	Totali debitore te tjere		2,862,509	29,599,702
2	Debitore te tjere - Furnitor debitor	409	3,822,438	18,172,478
	Totali debitore te tjere		3,822,438	18,172,478
	Totali te tjera kerkesa te arketueshme		6,684,947	47,772,180

2.3 Kerkesa te tjera Parapagime

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
I	Parapagime te dhena	416	634,329	363,316
I	Totali parapagime		634,329	363,316

3. INVENTARE

3.1 Lende pare dhe materiale

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Materiale te para dhe ndihmese	311	251,300	-
2	Zhvlerimi i materialeve te para (teprica kreditore)	391	-	-
	Totali materiale te konsumueshme (1+2)		251,300	-
1	Inventari i imet dhe amballazhet	32	4,440,687	3,736,932
2	Zhvleresimi i inventari te imet dhe amballazhit (teprica kreditore)	3922	-	-
	Totali inventari te imet dhe amballazhet (1+2)		4,440,687	3,736,932
	Totali		4,691,987	3,736,932

3.2 Mallra vlera neto

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Mallca	35	950,916,703	839,104,331
2	Zhvlerimi i malave dhë (produkteve) per shije (teprica kreditore)	395	(17,419,264)	-
	Totali - Mallra (1+2)		933,497,439	839,104,331

TRIMED SH.P.K TIRANE
NIPT: K51612031J

3.3 Parapagine per inventar

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Parapagine per inventar mallra	375	-	1,200,690
	Totali - Mallra (1)		-	1,200,690

4. AKTIVET FINANCIARE

4.1 Tituj pronesie interesa pjesmarrese

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Tituj pronesie te njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese	262	6,000,000	6,000,000
2	Zhvleresim per tituj pronesie te njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese (teprica kreditore)	2962	-	-
	Totali - Tituj pronesie ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese (1+2)		6,000,000	6,000,000

5. AKTIVTE AFTAGJATA MATERIALE

5.1 Impante dhe makineri

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Pajisje Prodhimi, Makineri e mjete te tjera	213	29,307,051	24,457,513
2	Zhvleresimi per Pajisje Prodhimi dhe Makineri e mjete te tjera (teprica kreditore)	2913	-	-
3	Amortizimi per Pajisje Prodhimi dhe Makineri e mjete te tjera	2813	(10,253,697)	(6,416,149)
	Totali - Impante dhe Makineri (1+2+3)		19,053,354	18,041,364

5.2 Te tjera instalime dhe pajisje

Nr	Emertimi	Nr	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Mjete Transporti	215	59,688,618	45,924,082
2	Amortizimi per Mjetet e Transportit	2815	(17,547,026)	(17,673,303)
3	Zhvleresimi per Mjetet e Transportit (teprica kreditore)	2915	-	-
4	Totali (4= 1+2+3)		42,141,593	28,250,779
5	Mobilje dhe pajisje zyre	2181	9,573,468	8,590,319
6	Amortizimi per Mobilje dhe pajisje zyre	28181	(5,265,392)	(4,298,919)
7	Zhvleresimi per Mobilje dhe pajisje zyre (teprica kreditore)	29181	-	-
8	Totali (8= 5+6+7)		4,308,077	4,291,400
9	Pajisje Informatice	2182	9,099,364	4,581,844
10	Amortizimi per Pajisje Informatice	28182	(3,523,446)	(2,089,679)
11	Zhvleresimi per Pajisje Informatice (teprica kreditore)	29182	-	-
13	Totali (9+10+11)		5,575,918	2,492,165
	Totali - Te tjera Instalime dhe Pajisje (4+8+13)		52,025,587	35,034,345

TRIMED SH.P.K TIRANE
NIPT: K51612031J

5.3 Pasqyra e Levizjeve te Aktive Afatgjata Materiale

Gjendja e Aktiveve Afatgjata Materiale ne date 31.12.2018

Emertimi	Toka, terrene, troje	Ndertim.Instali me pergjithshme	Instalime teknike Makineri Pajisje	Mjetet transporti	Pajisje informatike	Pajisje zyre dhe orendi	Totali
<i>Aktive te Trupezuara</i>							
Gjendje 31.12.2017	-	-	24,457,513	45,924,083	4,581,844	8,590,319	83,553,758
Shtesa	-	-	4,849,538	26,167,505	4,517,521	983,149	36,517,713
Pakesime	-	-		12,402,968			12,402,968
Gjendje 31.12.2018	-	-	29,307,051	59,688,619	9,099,365	9,573,468	107,668,503
<i>Amortizimi</i>							
Gjendje ne 31.12.2017	-	-	(6,416,149)	(17,673,303)	(2,089,679)	(4,298,919)	(30,478,050)
Shtesa illogaritur	-	-	(3,837,548)	(8,037,004)	(1,433,767)	(966,473)	(14,274,792)
Pakesime	-	-		(8,163,281)			(8,163,281)
Gjendje ne 31.12.2018	-	-	(10,253,697)	(17,547,026)	(3,523,446)	(5,265,392)	(36,589,561)
<i>Vlera neto 31.12.2017</i>	<i>-</i>	<i>-</i>	<i>18,041,364</i>	<i>28,250,779</i>	<i>2,492,165</i>	<i>4,291,400</i>	<i>53,075,708</i>
<i>Vlera neto 31.12.2018</i>	<i>-</i>	<i>-</i>	<i>19,053,354</i>	<i>42,141,593</i>	<i>5,575,919</i>	<i>4,308,076</i>	<i>71,078,942</i>

II. DETYRIME DHE KAPITALI

DETYRIMET AFATSHKURTRA

6. Deyrime ndaj institucioneve te kredise

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Huamarje afatshkurtra			
	- Bankat (overdraft)	4611	172,450,016	221,947,360
	Totali - Detyrime ndaj Institucioneve te Kredise		172,450,016	221,947,360

7. Arketime ne avance per porossi

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Parapagimet e marrë per porosi (<12 muaj)	418	486,768	6,585,934
	Totali - Arketime ne Avance per Porosi		486,768	6,585,934

8. Te pagueshme ndaj furnitoreve

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Furnitor per mallra, produkte dhe sherbime (< 12 muaj)	401	498,959,580	380,577,525
	Totali - Furnitore per mallra		498,959,580	380,577,525

TRIMED SH.P.K TIRANE
NIPT: K51612031J

9. Detyrime financime ortake

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Te drejta dhe detyrime ndaj ortakeve dhe aksionereve (<12 muaj)	455	2,662,638	416,735,879
2	Kreditor te tjere		-	4,199,817
	Totali Te tjera te pagueshme		2,662,638	420,935,696

10. Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Paga dhe shperblime	421	4,923,998	4,642,572
	Totali - Te pagueshme ndaj punonjesve (1+2)		4,923,998	4,642,572
2	Detyrime per Sigurimet Shoqerore dhe Shendetesore	431	1,617,755	-
	Totali - Te pagueshme ndaj Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetesore		1,617,755	-
	Totali - Te pagueshme ndaj punonjesve dhe Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetesore		6,541,753	4,642,572

11. Te pagueshme ndaj detyrimeve tativore

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Tatim mbi te ardhurat personale	442	500,325	1,849,042
2	Tatim mbi fitimin	444	5,351,152	413,382
3	Tatimi ne burim	449	1,219,941	-
4	Sigurimet shoqerore dhe shendetesore	431	-	1,431,403
	Totali - Te Pagueshme per Detyrimet Tatimore		7,071,418	3,693,827

12 . Detyrime te tjera

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Kreditore te tjere	467	18,371,019	-
	Totali - Detyrime te tjera		18,371,019	-

> DETYRIMET AFATGJATA

13. Detyrime ndaj te treteve (Financime ortak)

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Te drejta dhe detyrime ndaj ortakeve dhe aksionereve (<12 muaj)	455	416,755,879	-
	Totali Te tjera te pagueshme		416,755,879	-

TRIMED SH.P.K TIRANE
NIPT: K51612031J

14. Kapitali dhe rezervat

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Kapitali i nenshkruar i paguar	101	60,900,000	60,900,000
2	Rezervat te tjera	1071	3,548,610	3,548,610
3	Fitimi/Humbja e pasperndare e akumuluar	108	110,235,434	56,408,864
4	Rezultati i ushtimit	109	41,802,073	53,826,570
	Totali i Kapitalit dhe rezervat		216,486,117	174,684,044

TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET

15. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Shitje mallrash	705	2,082,391,199	1,854,461,331
	Totali - Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit		2,082,391,199	1,854,461,331

Te ardhurat nga shitja jane vleresuar me vleren e drejtë te shumes se arketuar ose te arketueshme, duke marre parasysh shumen e zbritjeve te ofruara dhe taksave te lidhur me shitjet. Vlera e te ardhurave nga shitja e AAM pasi eshte zbritur vlera neto kontabile eshte pasqyruar per fitim/humbje neto nga shitja e AAM . Te ardhurat nga shitja sipas FDP jane ne vleren 2 085 643 321 leke dhe jane pakesuar per vleren e te ardhurave nga shitja e AMM per 3 252 122 leke dhe ne pasqyren e te ardhurave te bilancit jane pasqyruar per shumen 2 082 391 199 leke .

16. Te ardhura te tjera te shfrytezimit

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Te tjera	7088	52,439,857	79,777,996
	Totali - Te ardhura te tjera te shfrytezimit		52,439,857	79,777,996

Ne te ardhurat e tjera te shfrytezimit jane pasqyruar te ardhurat si rezultat i kredit note – ve , zbritjeve te ndryshme te lidhura apo kushteuara me volumin e shitjeve , me besnikerine ne treg dhe performancen ne treg si rezultat i e sciles shoqeria ka perfituar te ardhura si skonto apo bonuse ne ulje cimimit sipas periudhave perkatese te llogaritura nga shoqerite e huaja per vleren 52 439 857 leke

17. Lenda e pare dhe materiale te tjera te konsumueshme

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Blerje /Shpenzime mallrash ,sherbimesh	605	(1,745,435,996)	(1,592,500,100)
	Totali - Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		(1,745,435,996)	(1,592,500,100)

TRIMED SH.P.K TIRANE
NIPT: K51612031J

Ne shpenzimet per lenden e pare dhe te tjera te konsumueshme jane pasqyruar vlera e kostos se mallrave te shitura per vitin ushtrimor . Nga te ardhurat e realizuara nga shitja e mallrave pasi zbritet kostoja e mallrave te shitura rezulton nje marzh tregtar bruto ne shumen prej 336 955 203 leke ose nje marzh tregtar bruto prej 16.18 % ne raport me shitjet e mallrave.

18. Te tjera shpenzime materiale

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Blerje /Shpenzime te tjera	608	(46,115,993)	(16,354,078)
	Totali shpenzime te tjera		(46,115,993)	(16,354,078)

19. Paga dhe shperblime

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Pagat dhe shperblimet e personelit	641	(77,567,274)	(70,140,689)
	Totali - Paga dhe shperblime		(77,567,274)	(70,140,689)

20. Shpenzime sigurime shoqerore dhe shendetsore

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Sigurimet shoqerore dhe shendetsore	644	(11,327,056)	(9,843,541)
2	Kontribute dhe kuota te tjera per personelin	645	-	-
	Totali - Sigurimet shoqerore e shendetsore		(11,327,056)	(9,843,541)

21. Zhvlersimi i mallrave

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Zhvleresimi i mallrave dhe materialeve te konsumueshme	688	(17,419,264)	-
	Totali - Zhvleresimi i Mallrave dhe materialeve te konsumueshme		(17,419,264)	-

Shoqeria ka bere vlersimin e Inventareve te cilat duhet t'i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e raportimit. Kërkesa për vlerësimin e inventarit me vlerën më të ulët mes kostos dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për tu përfunduar dhe shitur e detyron njesinë ekonomike që të regjistrojë në kontabilitet humbjet nga zhvlerësimi në momentin kur ky i fundit ndodh. Aktualisht shoqeria ka bere një analize te mallrave ne prag skadence apo dhe te skaduara , te demtuara etj per te cilat ka llogaritur një zhvlersim te ketyre mallrave ne vleren perej 17 419 264 leke.

22. Shpenzimi konsumi dhe amortizimi

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Konsumi/amortizimi i aktuveve afatgjata	6812	(14,274,792)	(10,312,149)
2	Totali - Shpenzime konsumi dhe amortizimi (1)		(14,274,792)	(10,312,149)

TRIMED SH.P.K TIRANE
NIPT: K51612031J

Shoqeria ka llogaritur amortizimin e AAM bazuar ne vleren neto kontabile ne fillim te vitiit, ndersa per shtesat gjate vitiit ajo ka llogaritur amortizmin ne diten e pare te muajit qe pason blerjen e AAM. Normat e amortizimit te perdorura nga shoqeria per vitin 2018 jane te barabarta me normat fiskale te amortizmit.

23. Shpenzime te tjera shfrytezimi

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
I	Sherbime nga te tretet			
1	Traitime te pergjithshme	611	-	
2	Qera	613	(37,001,138)	(37,673,074)
3	Mirrbjatje dhe riparime	615	(4,330,074)	(2,883,411)
4	Sigurime	616	(2,576,352)	(1,728,802)
5	Kerkime dhe zhvillime	617	-	
6	Te tjera	618	(10,377,170)	(8,980,167)
	Totali - Sherbime nga te tretet (1+2+3+4+5+6)		(54,284,734)	(51,265,454)
II	Sherbime te tjera			
7	Personel jashte njesise	621	(17,865,168)	(18,884,815)
8	Pagesa te ndermjetesve dhe honorare	622	(11,756,944)	(11,328,687)
9	Shpenzime per koncesione, patenta, licensa dhe te ngjashme	623	(8,741,568)	(11,524,886)
10	Publicitet, reklama	624	(15,375,603)	(22,614,688)
11	Transferime, udhetime, djeta	625	(9,365,751)	(15,923,302)
12	Shpenzime postare dhe telekomunikimi	626	(3,012,093)	(2,630,869)
13	Shpenzime transporti per blerje	6271	(266,125)	(3,000)
14	Shpenzime transporti per shitjet	6272	-	
15	Shpenzime transporti per personelin	6276	(150,000)	(26,316)
16	Sherbime bankare	628	(1,700,792)	(24,375,414)
	Totali sherbime te tjera (7+8+9+10+11+12+13+14+15+16)		(68,234,043)	(107,311,977)
III	Tatime dhe taksa			
17	Taksa tarifa doganore	632	(2,666,424)	(1,661,882)
18	Akciza	633	-	
19	Taksa dhe tarifa vendore	634	(492,309)	-
20	Taksa e rregjistrimit	635	-	
21	Tatime te tjera	638	-	
	Totali - Tatime dhe taksa (17+18+19+20+21)		(3,158,733)	(1,661,882)
IV	Shpenzime te tjera			
22	Sponsorizime, ndihma dhe fiancime te tjera te ngjashme	653	(1,700,072)	(480,000)
23	Shpenzime per prite dhe perfaqsime	654	(8,431,722)	(5,444,644)
24	Gjoba, kamtevonesa dhe demshperblime	657	(1,341,476)	(1,268,681)
25	Shpenzime te tjera	658	(469,760)	(3,226,105)
	Totali -shpenzime te tjera (22+23+24+25)		(11,943,030)	(10,419,431)
	Totali - Shpenzime te tjera (I+II+III+IV)		(137,620,541)	(170,658,744)

TRIMED SH.P.K TIRANE
NIPT: K51612031J

24. Te ardhura te tjera

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Te ardhurat/shpenzime nga interesat mbi huate dhe bonot	767	(6,761,494)	(11,194,140)
2	Te ardhura / shpenzime te tjera financiare (marreveveshej huaje me ortaket)	768	(25,485,729)	-
I	Totali -Te ardhura te tjera financiare (1+2)		(32,247,223)	(11,194,140)
3	Fitim nga kembimet dhe perkthimet valutore	769	32,878,869	12,123,842
4	Humbje nga kembimet dhe perkthimet valutore	669	-	(1,299,057)
II	Totali Fitim neto nga kembimet dhe perkthimet valutore (3+4)		32,878,869	10,824,785
	Fitime/humbje neto nga shitja e AMM		(987,565)	-
III	Totali fitim /humbje nga shitja e AMM		(987,565)	
	Totali te ardhura te tjera e te ngjashme (I+II+III)		(355,919)	(369,355)

25. Zhvlersimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Zhvleresimi, konsum dhe amortizim per aktivet financiare (te matura me kosto ose me kosto te amortizuar)	686	(26,833,267)	-
	Totali - Zhvleresimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra		(26,833,267)	

Shoqeria ka bere vlersimin e te drejtave te arketueshme dhe rezulton se per klienet pa shprese arketimi ka bere zhvlersimin e tyre duke paraqitur si shpenzime ne llogarine fitime dhe humbjeve te vitit.

26. Rezultati ushtrimor

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018	Gjendje 31.12.2017
1	Fitimi (humbja) para tatimit mbi fitimin	109	57,880,954	64,060,671
2	Shpenzimi ratim fitimit te periuudhes	694	(16,078,881)	(10,234,101)
3	Shpenzimi i tatin fitimit te shtyre	695		
	Totali - Fitimi (humbja) para tatimit (1+2+3)		41,802,073	53,826,570

Fitimi neto i shoqerise per vitin 2018 rezultobn ne shumen 41 802 073 leke .

TRIMED SH.P.K TIRANE
NIPT: K51612031J

27. Rezultati tatimor

Nr	Emertimi	Nr.llog	Vlera
I	Rezultati ushtrimor		57,880,954
II	Shpenzime te panjohura		49,311,589
1	Shpenzime te panjohura	636	1,341,475
2	Shpenzime te pazbriteshme donacione	6,181	190,400
3	Gjoba demshperblime	618pz	953,234
4	Vlera neto e AAM te pazbritshme te aktiveve te shitura	652PZ	987,565
5	Te tjera shpenzime te pazbritshme	625.4 pz	1,586,384
6	Zhvlersimi i mallrave	681,1	17,419,264
7	Zhvlersimi i klienteve	681,2	26,833,267
III	Fitimi para tatimit		107,192,543
8	Minus humbjen fiskale te imbartur		0
IV	Fitimi i tatushem pas zbritjes se humbjes fiskale		107,192,543
9	Tatim fitimi 15 %		16,078,881
V	Fitimi neto fiskal		91,113,662
VI	Fitimi neto tregtar		41,802,073

Per periudhen tatimore 2018, shoqeria tregtare TRIMED SHPK, rezulton me një fitim tregtar bruto per shumen 57 880 954 leke dhe i modifikuar me shpenzimet e panjohura fiskalisht rezulton fitimi para tatimit ne vleren 107 192 543 leke. Tatim fitimi eshte llogaritur me shkallen tatimore standarde sipas legjislacionit fiskal ne fuqi 15% dhe rezulton ne shumen 16 078 881 leke. Fitimi neto fiskal eshte ne shumen 91 113 662 leke ndersa fitimi neto tregtar rezulton ne vleren 41 802 073 leke.

Tirane, me 28/03/2019

ADMINISTRATORI



HARTUESI